



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.04, datë 01.08.2023

PËR
MIRATIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT PËR OBJEKTET:
“STRUKTURA SHËRBIMI NË STACIONET E PLAZHIT”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKITË: SHKODËR, LEZHË, DURRËS, KAVAJË,
RROGOZHINË, VLORË, HIMARË DHE SARANDË

Në mbështetje të Nenit 28, pika 1, dhe 41, pika 1/1, të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Nenit 19, pika 3, shkronja “ç”, të VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr.171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.23, datë 28.02.2020 “Për përcaktimin e procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e aplikimeve, brenda Zonës së Brezit Bregdetar”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejeve të Ndërtimit për: “39 struktura shërbimi në stacionet e plazhit, me vendndodhje në Bashkitë: Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Himarë dhe Sarandë.
2. Harta e vendndodhjes së 39 strukturave të shërbimit në stacionet e plazhit, sipas territorit administrativ të secilës bashki, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejeve të Ndërtimit, të shoqëruara nga projekti arkitektonik, i jepen subjekteve zhvilluese veçmas për secilën strukturë shërbimi në stacionin e plazhit, vetëm pas depozitimit të kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve, të nënshkuara mes subjekteve dhe NJQV-ve përkatëse.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

